

NIJAZI RAMADANI

# THJERRËZ

*(Poezi)*



RRJEDHA 2019

## **Botues**

Shb "Rrjedha", Gjilan

Biblioteka Arbëri

e-mail: [rrjedha\\_nr@yahoo.com](mailto:rrjedha_nr@yahoo.com)

*Tel.Fax:* +383 44 125733

Redaktor: Biser MEHMETI

---





# LETRAT



## VETËFLIJIMI<sup>1</sup>

Më ndalë n fjalën  
Si ta presë frymën

Thash t'i bie vetës  
E ta ndaj mesë perms

Se s'mbetë më  
As vend  
As kuvend  
Kur e shkelë n dheun  
S'hoq dilemma

---

<sup>1</sup>Poezi botoi Euro-Rilindja, Tiranë, më 27 gusht 1996.

Të vritë m me ta apo  
Të ik pas të ikurët  
Thash s'ka më  
as fjalë  
as tokë  
as liri

por uni im  
si uni zjarri digjët  
Flakë e tym i doli

Pakë e hiq mbet në mua  
Si ta heq edhe atë

Në kokë  
në zemër  
shpirtë  
I trazuar fund e krye  
Shprishur deri në grykë

---

S'mbajë dot drejtpeshim  
Nuk mbahem më as për dheun

Prej të cilit dolëm  
Në cilin hym  
As për tokën

Është tapia ime e fundit  
U vra edhe dashuria pas fjalës  
Se më lidh liria  
edhe jeta

E kë putur mespërmes  
Si t'a bëjë pa atë

Kur dheu është përzier me ne  
Nuk është nën as mbi  
Nuk e ndjejë fare atë  
Andaj ku do që shkoi  
një epitafë ...

---



## MOSTRUM NJERIU<sup>2</sup>

Eshtrat e princ Llazrit  
Ngjallë në lugatin

Bën një monstrum njeri  
Fotografia e të cilit ngel  
Gozhduar në muar

Më me pamje do ishte i varur  
Me atë imazh të vrazhdtë

Me kohën e tij  
Pusti u hoq zvarr  
Më me dëshirë e kasha parë  
Të varur pas zvarr  
Edhe historia e tij.

( Korrik 1989, “Bota poetike”, Fjala jonë”, Prishtinë,  
1992 )

---

<sup>2</sup> Poezi botoi Euro-Rilindja, “Bota poetike ’92”),  
me 27 gusht 1996.

---

# HUMAZH



## HUMAZH PËR BACËN

Me Ty Adem Demaçi  
u nisëm e bëmë udhë

u ndamë me të pa udhët  
dhe vazhduam me Ty  
i bërë sëbashku  
si thuprat  
dikur Skënderbeu  
dhe nuk u thyem  
kurrë me Ty

---

I këpute vargojtë  
e robërisë

si litarët një nga një  
me Ty

prapa grilave qëndrove  
si zë i qëndresës  
Qëndrim me Ty

E para penë  
me "Gjarprijtë e gjakut"

filluam  
udhëtuam nëpër kohë  
mënxyrash  
robënim

---

Qëndruam  
për të mos ikur

Kur puqën pushkët  
derisa ranë prangat  
i këputëm  
me Ty

Prapa mbetën ata  
që nuk besuan por nuk u  
ndanë  
si ditëm dhe si mundëm  
me të parët dhe fundit  
luftëtarët me Ty  
Adem Demaçi  
liria ishte caku  
Yni i fundit.

Arritëm me Ty  
Amin!

- 29 KORRIK 2018

---

## **LUMË ISHTE ALI PODRIMJA**

Lumi nis të rrjedhë  
si një pikë uji në embrion

Numëruar në shtatë fazat e hënës  
si gjethi i hurmës së tharë

Pikë-pikë i bie vijës gjarpërore...  
Rrjedha e lumit lëviz e nuk ndalet

Lumbardh e bënë shtratin e vet  
me degën e vet

---

Lumi pranë brigjeve  
të Senes në Paris  
duke numruar tik-taket

Orës së ndalur  
në atë Lum Lumi  
nëndrinia

Ju e pritët derisa ikën  
në amshim shtratit të tij  
të fundit

Lumi të priti pas  
disa dekadash  
Sa e kryet misionin  
e Lumit Nëndrinia

Ikur bashkë me te,  
Në gjirin e shtratit  
Lum tok ngelët përjetësisht..

---

**IMAZH**





**IMAZHI I PASHLYESHËM**  
(Tri ikaonat e janarit: J- B. Gërvalla,  
K. ZEKA)

Pamje e pashlyeshme,  
Herë më përthehet  
ndër duar  
Ngel si ajri  
i pastër e vesë  
Mbi qepallë  
loti i ngrirë

---

Humb nënkëmbë dheu  
Rrëshqitët  
përtej maleve  
Pa i humbur shpresat  
Prapë kthjem  
në tokë të zhuritur

Humbësi i humb të humburat  
gjithaçka  
Fituesi fiton të humburat  
Fiton gjithçka

Edhe tri ikaonat e janarit  
Të harruarë  
si hije u ngjallë  
Pegasi mbi kokat e tyre  
Qëndron fuqishëm  
Udhërrëfyeshëm lartësohen

---

Hija e plisi  
si hija lisi  
Dëfton si ylberë  
Me shtatë ngjyra,  
Harta e tokës sime  
Me shtatë yje  
Përtej shtatë maleve  
e kodrave

Trupon si hije  
vetëtimë  
Përshkon vijen  
në horizontit  
Bie vertikalisht

---

Në përjetësi  
vie imazhi i tij

Mbi ato rrasa guri  
shkëlqen  
Flakërimë bie  
si hije e gjallë

Imazhi i pashlyeshëm  
ngel ikonë  
e ardhmërisë...

---

**AJO PIKË GJAKU**  
**MBI KËTË DHE**

Fshij lotët  
Të mos i thahen  
rrënjët nënëdheut  
Rrjedha rrjedh rrrëke  
rrudhave të ballit  
Kah ai shtrat lumi i larë

Aty ku flet vepra  
Dheu nuk tretet  
Emër të përvetshëm  
merr jeta

Mallkimi bie mbi  
Qoftëlargun

---

Një tufëz dritë dielli  
Dritëzon nga faqja e hënës  
Zgjimi pulson  
nëpër zemra

Fjalën nanë s'bartet  
dot nga era  
Ajo pikë gjak  
mbi këtë dhe  
Çelë si lule  
mbi kokë t'Shqiponjës

---

**DY FJALË NANE**

Fjalën nanë  
nuk do t'a marrë  
dot era

I pikoi gjak mbi dhe

Mbi të notoi  
Zogu i lirisë

I pikoi loti  
mbi kokë te nënlokës

---

Të mos i shterrën  
burimet e nëndheut

Fshij pikat e lotët  
Të mos i thajnë rrënjët

Rrjedha rrjedh rrrëke  
rrudhave të ballit

Në shtrat lumi  
të larë e tharë

I këndoi që t'i fletë  
Vepra

I përkund fati  
Që nuk e treti  
as dheu e jeta

Robit që i dha emër  
Ndarje mos të ketë

---



Prej asaj që i përftoi jeta  
Nëse do ta ruaj

Mëmëdheu

mallkimi të bie  
mbi Qoftlargun.

Një tufëz dritë  
që bien prej dielli

Me atë copë dritë  
që hëna reflekton

Zgjedh se të piu  
Korbi kobi

---

Zgjohu me atë  
që fletë zemra

Mendoj për atë  
që e mban mendja

Gjallë dhe mos të vajtojnë  
për të gjallë

Në jetë të mos i këndojë  
Vdekja

Në ecjakje ec  
Dy fjalën nanë

---

## AMANET

♥ Është një botë tjetër  
zemra e nanës time  
Gjithçka e shejtë  
isha mbreti...

Po nëse në tokë troket  
ai isha fëmijë i saj  
në bark të nanës  
ose askun tjetër.

---

Fëmijë ndoshta jo  
sa kthjellësia e saj, .  
fëmijë që provova  
ndjesin e kësaj fjale.

Jam rrit si rebel  
rob i asj kohe  
i lirë me ka mësua  
me qenën i tillë ne jetë

Në mendim,  
Që kam bërë  
si femijët me parime,  
me dashuri  
për vendin tim  
dhe për tjetrin.

I ka mësuar  
të jenë të sinqert  
gjithmonë me të vërteta

---

arma ma e fortë e njeriut

të ecë me dinjitet  
si sot me lutjet  
lutje me shpirt,  
lutje dje edhe nesër

Për djermtë e vajzatë  
përgjithë ato fëmijë  
që me zë e shpirt  
qajnë e qeshin

ishin lotë e vaj nane  
lotë e lutje

që ngjallët shpresën,  
por se përtej kësaj

nuk shihej kacafytejet  
me njeri-tjetrin.

---

**IMAZHI YTË –  
NANË**

Nanë tashmë ke ndërrue  
Dhomën

Kurrë nuk i kam harruar  
shikimet

Ditët që më  
prangosën

---

Sa herë ti  
më përcolle  
Si sot mbaj kujtimin  
për ty

Në dorë kisha librin  
Fletë dhe laps m'i morën

Shkrime  
që u bënë  
Ushtimë e maleve  
Dhe m'i kthyen më rreze drite

Pata marrë vesh  
se ishe mërzhitur sa s'ka më

Nuk t'i pashë lotët  
as vajin nuk e degjova

---

atë ditë  
dhembjen e rëngimin  
nuk e shpalose  
kurrë

As ballin e m'rollur  
e të mbulluar nën shami

Te dera në vend  
të lamtumirës

Por e mbaje thellë  
në shpirt të fshehur  
nën dry

'Iu tha gardianëve  
se fëmijë  
po e mbani në

vetmi

---



Kur po bie muzgu  
dhe errësira

E mbeshtjell edhe  
burgu zi e më zi

Më fanitet fytyra  
sikur diku larg

Prore më fiksohet  
imazhi ytë,  
nanë

Sa të jetë jeta  
më ndjek  
vegullimi  
për Ty

Mos të zgjohem  
me ëndrrime

---

Mos më pyete  
për plagët  
që varrosen robrinë

Mos e kujto  
atë që vajti  
e iku përsëri

Tek e kaluara  
s'ka kthim

vetëm paqja  
qoftë me Ty –  
I yti jam

Kurrë më s'u trondite  
sikur atë ditë  
përsëri

---

Se ngritjet dhe  
rëniet janë një

Dhe sa herë dilje  
shpesh tek dyert  
për të më pritur

Se si po vij  
dhe a po vij

Herët a së voni  
do të shbragosëm  
nga ajo hapsane

Prapë do të kthej  
në shtëpi i lirë

Do të kthehem atëhere  
edhe kur nuk të kemi  
Edhe kur të falëm Ty.

---

**RRJEDHË N'UJË ...**

N'uji ec rrjedhës e vrap  
Ecë N'uji me te

Vorbullë qëndron në drejtpeshim  
as lumi nuk turbullohet  
por shkumëzohet  
lëvize tok nëpër shtratin e tij.

Uji i cili rrjedh  
N'ujë katasrifen e kalon –  
mënxyrë kohe  
profecia nuk ia fsheh yjet.

---

Kush ecën rrjedhës  
nuk do harron.

ecë me rrjedhë vertikal

Kush ndalet në amshim  
ëndrron botën.

Përmotshme jeton  
në parajsë.

---

## *TESTAMANET*

Rrjedhës së gjatë  
notoi

Me anijen e shpëtimit  
nis të rrjedhë  
një pikë uji u kthyer në lot  
numëruar  
në shtatë fazat e hënës  
si gjethi i hurmës

Në një tufë vargojë  
loti i rrodhi pjerrëtas  
në vijë prore ec  
rrjedha e tij lëviz

Ai nuk ndalet  
në rrjedhë ecë  
bën shtrat n'ujë vet.

---

## **BOTA IME**

I.

I lumtur ndjehem  
me të gjitha rrjedhat  
si të lumit

Me ato që sjell vyrtyti im  
Ndjehen sikur të tjerët  
edhe unë  
Ajo rrjedhë  
si sythë prej saj

Nënës dhe babai tim  
Vëllazëri dhe motra të mia  
Djelit dhe vajzës sime

---

Miqëve dhe mikeshave të mia  
Njeriut sikur te gjithë njerëzia.

II.

I gëzohem të gjitha  
Gëzimeve

Gëzimeve si të gjithë  
të tjerët

Hidhërohem aq  
sa hidhërohen të tjerët

Vaji dhe lotët  
më mbërthejnë

Shtohen dhe  
vërshojnë si lumë

---



Shterrën si në shkretirë  
Plakos universin tim.

III.

Gjithë atë që i kam  
për zemër

Flej edhe me zemrat  
e të tjerëve

I urrej gjithë urrejtjet e njerëzëve  
Humbje më sjell jeta

Kurrë më gjynjëzim  
I robëruar ...

Sakrifikohem sikur qeniet tjera  
Nuk mbetëm i robërua.

---

IV.

I lumtur jam

Lumturia ime shihet në sytë  
e fytyrat e tjerëve

Ndarja nuk më pret

Si gota e qelqtë  
thyhet dhe nuk ngjitët

I dashuruar jam

Kur dashuria ime  
ndahet dhe bashkohet në  
thërmija

Sikur bota ishte shthurur  
e thurrët

Përsëri

Dashuria ndahet në dysh  
Një zemër është dashuruar.

---

## UNË E TI!

Sikur të kish unë - Ty  
tashmë do t'i qaja malet  
fushat dhe detin  
tejpërtej

per te arritur gjerë  
tek era me Kanellë  
dhe Rosmarinë

---

Por sikur të ishim  
Sikur ditur moti  
do të ngisja pas

në secilin vend  
skaj më skaj botës

Rend me rend  
duke aderuar  
me thërriat  
e humbura  
të botës sime

---

Atë botë  
do të kerkojë  
për të hynë

në kopshtin e Adamit  
dhe Evës

me aromë kanelë  
e rosmarinë

Atë botë do ta vemi  
vetë në të dy

Në zemrat mbyllur  
nën dry

---

Nëse të kam gjetur  
në kohën e duhur

mos pyet për çka  
dhe përse

mos u mbyll  
nënkthetrat e vetmisë

vetmin e keshim  
të ndarë  
në dysh

dashurinë  
në dyfish  
zemrë e shpirtra

trupin ngjizur  
në dyll –  
Pandarje

---

## IMAZHI I NGRIRË

Kur po ndodhem para teje  
aty ku u takam një ditë me Ty,

nëpër banakët  
dhe stendat e librave

më dukej sikur të flisja  
kundroja me sy:

është e mundur të ndodh  
të jam reshtu,

---

mos brehej shpirtëror  
brenda vetes  
nga një dashuri

që e ndjej  
të jemi skuqem para teje

kaq afër  
    e kaq larg  
        e kaq gjatë,

pafundësisht e gjatë  
dhe pazverdhur,

kalcifikuar me trupin  
dhe fiksuar  
në trurin tim.

---



II

Athua çfarë  
mund te bëhet  
me imazhin e fiksuar

atë ditë  
aty të vinte  
një shikim i ngulitur  
që reflektohej  
shëmbëllimi

më tutje e përtej  
jam shtrënguar

me ashtin e skeletit tim  
si merimangë ngjizur.

---

Imazhi yt më erdhi  
nga fundi i asaj dite

sot e atë ditë ishte përmytur  
aty përjetësisht

Ti e ndjeve,  
po çka ngeli

aty se ndodhesh  
në botën time.

III

Është ajo gjendje  
e fiksuar amfore

në kujtesë

ajo që më rishfaqet sërish  
nëse ikën në këtë vere,

---

këtë verë e ke një haber  
në imazhin tim

IV.

po këtë qershor kujtoje  
në ditën e gjashtëmbëdhjetë

Qofsh edhe me gurin e madhe  
te Sizifit ngjitur,

gjithsesi do ta ndjesh  
drithërimën e ndjenjës së ngrohtë

Unë do ta ruaj  
në kujtesë  
atë imazh të ngrirë.

---

## PËRMBAJTJA

1. Vetëflijimi .....	9
2. Monstrum njeriu.....	13
3. Lumë ishte Ali Podrimja.....	14
4. Imazhi i pashlyeshëm.....	17
5. Ajo pikë gjaku mbi këtë dhe .....	20
6. Dy fjalë nane.....	22
7. Amanet .....	26
8. Imazhi ytë – nanë .....	29
9. Humazh për bacën.....	36
10. Rrjedhë n’ujë .....	38
11. Testament.....	40
12. Bota ime.....	41
13. Unë e Ti .....	45
14. Imazhi i ngrirë .....	49
15. Shënime për Autorin.....	58

---



**Nijazi Ramadani** lindi më 14 shkurt 1964 në Kokaj, te Gjilanit ( Rep. Kosovë). Katër klasat e para të fillores i kreu në Kokaj, kurse gjysmëmaturën në Pogradjë të Gjilanit, ku i kreu mësimet e para (shkollimi fillorë 1972-1979) dhe shkollimin e mesëm (Gjimnazin Z. Hajdini,

---

drejtimi Matematikë-Teknikë, dhe atë të lartë të edukimit i mbaroi Universiteti Prishtinës në Gjilan dhe Prishtinë.

Fakulteti i Edukimit, i diplomuar në programin (Matematikë-Informatikë, Universiteti i Prishtinës, në Prishtinë, në temën *Teorema e Talesit*. Shkollim ky që ishte bërë me një bazë të mirë për ta thelluar edukimin, si edhe e ka përvijuar krijimtarinë e nisur që nga bankat e shkollës fillore, njëherit ka arritur një integrim të plotë në shkencë dhe arte.

### *Veprimtaria*

---

Krijimtarinë fillestare për fëmijë dhe të rritur e ka filluar më 1977, duke e publikor në periodikun letrar në viteve shtatëdhjeta dhe tetëdhjetë, kur edhe anatemohet nga jeta publike përshkak të rreshtimit politik në Lëvizjen Kombëtare, botimit të fletushkës **Ushtima e maleve**, që ishte cilësuar *sipamfletë armiqësor(nacionalist-irridentist* të atyre viteve dhe pikërisht për këtë burgoset më 24 korrik të vitit 1981. Merret me shkrime letrare,

---

publicistike, kulturore dhe politike të cilat i boton herë pas here në të përditshmet dhe periodikun shqiptar. Shkrimet mund t'i gjenden edhe të botuara në të përditshmën "Rilindja", pastaj në revistën letrare e periodike "Jeta e Re", "Pionieri" GEPi, Flaka të Shkupit, "Haemus", Bukuresht, Gazeta Athina, Athinë, Gazeta Shkodra si dhe "Shkëndija", "Revista Paqja", të Prishtinës, por edhe në gazetat shqiptare "Shekulli" të Tiranës dhe "Koha jonë". Ramadani më pas vazhdoi me paraqitjet në gazetën "Bujku", "Euro- Rilindja, Tiranë, "Koha ditore", "Zëri", "Bota e Re", "Fokus", "Epoka e re", ku punoi pas vitit 2000, dhe botoi varg shkrimesh në të përditshmet: "Express", "Infopress" "Kosova sot", "Ilriapost", "Pavarësia Neës" "Lajm" të Prishtinës, Agjensia e lajmeve "Kosovapress. Gjatë punës së tij u muar me të gjitha zhanret e shkrimeve gazetareske, duke përfshirë shkrimet hulumtuese dhe të angazhuara, kritikë, ese, editorial, koment, replikë, reportazh, shkrimin enciklopedik dhe referencial, skicë, fejton, recension, etj, në mediat elektrinike dhe të

---

shkruara ishte profesional si: redaktor përgjegjës te e përkoshmja "Ushtima e maleve" (2001/2002, në redaksitë Radio Albana (Kumanovë) dhe ajo Rinia (Gjilan) në të cilat punoi, ku përvç punës në gazetari, botoi artikuj të ndryshëm dhe shkrim letrare dhe publicistike, duke përfshirë edhe mbi dhjetra shkrime enciklopedike në wikipedia (sq:shqip dhe en:anglisht).

Është autor i dhjetë librave letrare shkrime për letërsinë, teatrin, artet pamore, si dhe kritikë letrare, prozë artistike, tregime, romane dhe drama, publicistikë e shkrime polemike Ka botuar recensione, vështrime, artikuj, esse, trajtesa e shkrime të angazhuara hulimtimuese në revista e ndryshme shqiptare dhe jashtë vendit, duke trajtuar në to çështje të ndryshme sociale, kulturore shqipe dhe të krijimtarisë letrare në përgjithësi. Disa punime e tij janë përkthyer në gjuhë të tjera.

### *Puna*

---

Punon mësimdhënës në shkollën "Mulla Idriz Gjilani", të Gjilanit, Botus te Klubi i artistëve,

---



krijuesve, gazetarëve “SHB. Rrjedha”, udhëheq edicionin “SHB. Rrjedha”, ku botoi një varg veprash, dhe editoi revistën "Ushtima e maleve", është anëtar te Shoqata e shkrimtarëve të Kosovës. Jeton, punon dhe krijon në Gjilan.

### **Vepra të botuara:**

1. **“Dheshkronjë arbri-** ( përmbledhje me poezi), *"Jeta e Re” Prishtinë, 1995,*
  2. **Kosova dhe vetëvendosja,** *"SH.B. “Rrjedha" (Ushtima e maleve), Gjilan, 1998,* trajtesë historike dokumentare dhe politike
  3. **Një qasje në teatër,** *SH.B. Rrjedha, 2004, Gjilan*
  4. **Vrojtime artistike,** vështrime letrare, *SH.B. Rrjedha, Gjilan, 2006.*
  5. **Qasje tjetër për skenën,** 2006 SH.B. Rrjedha" Gjilan
  6. **Imazhe kohe**<sup>[5]</sup>, *poezi:1978-2008*SHB. Rrjedha, Gjilan, 2008
-

7. **Imazhi i ngrirë**, (*roman*)i marrë për botim në konkursin letrar 2006 nga SH.B. Buzuku, bot. SHB "Rrjedha", Gjilan, 2012.
8. **"Vështrime letrare"**, (përmbledhje shkrimesh të botuara nëpër revista dhe të përditshmet shqipe) bot. "Rrjedha
9. **"Azgani&Ylber(i)ja ~ (Imazhi i gjallë"**, Dramë marrë në Konkursin "Katarina Josipi", financuar nga MKRS të Kosovës, 2013| bot. Rrjedha, 2012.
10. **Shtegtim në histori**  
– *Monografi për Kokajt 1842-2012.*  
bot. *Rrjedha*, Gjilan, 2012.
11. **Shtegtim në histori - I-**  
*Gjilani qender e lëvizjeve dhe e rezistencës kombëtare në juglindje të Kosovës 1941-1951( Studim)*

**Përmbledhja me poezi, vepra e radhës**

---

Katalogimi në botim – (CIP)

Biblioteka Kombëtare e Kosovës  
“Pjetër Bogdani”

821.18-1

Ramadani, Nijazi

Thjerrëz : (poezi) / Nijazi Ramadani. –  
Gjilan : Rrjedha, 2018. – 67 f. ; 21 cm.

**ISBN 978-9951-**

ISBN 978-9951-453-28-8



